1.6	F.V. GPS (NTP Server)	Cope	1		
1.7	F.V. RACK + (KVM Console)	Set	1		
1.8	F.V. INVERTER (110 Vdc-230 Vac)	Cope	2		
1.9	F.V. Modul per cdo Rele - kompatibel 61850 Driverat + Upgrade Firmware per cdo Rele	Cope	15		
1.10	Set Fibrash Optike	Set	1		
2	PUNIME MONTIMI, KONFIGURIMI, TESIMI				
2.1	Testim dhe Komisionim Lokal i Sistemit	Set	1		
2.2	Testim me Sistemin qëndror SCADA/EMS	Set	1		
2.3	Dokumentacion	Set	1		
Çmimi total (Mallrat)					_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkreisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

1. Hyrje

Qëllimi i këtij dokumenti është të përshkruajë gjendjen aktuale të sistemit të kontroll monitorimit në nënstacionin Babicë dhe të gjitha kërkesat që duhet të përmbushë sistemi i ri i kontroll monitorimit për të monitoruar dhe kontrolluar këtë nënstacion. Me upgrade të sistemit aktual nënkuptojmë ofrimin e komponentëve hardwarik dhe softwarik aktual por në versionin më të fundit ose një sistem të ri i pavarur, i cili përmbush të gjitha karakteristikat e paraqitura në këtë dokument. Në specifikimet teknike shprehen qartë të gjitha pajisjet hardwarike dhe komponentët softuerik të cilat përmbushin standartet më të fundit të komunikimit ndërmjet pajisjeve dhe sistemeve, dhe gjithashtu karakteristikat teknike për të ofruar një operim korrekt dhe të sigurtë të sistemit.

2. Kërkesat e përgjithshme

3. Sistemi ekzistues SCMS (Substation Control and Monitoring System)

Nënstacioni 220/110/35 kV Babicë monitorohet dhe kontrollohet aktualisht nga një sistem kontroll-monitorimi Siemes AG (SICAM PAS & WINCC) i konfiguruar përkatësisht në pajisjet: Server Industrial (SICAM Station Unit) dhe ndërfaqja HMI e operatorit kompjuter Workstation.

Komponenti SICAM PAS aktualisht operon mbi sistemin operativ Microsoft Windows XP embedded me Service Pack 2, bashkë me disa hotfixe të instaluar. Komponenti SICAM PAS FULL SERVER i instaluar në serverin e këtij sistemi është SICAM PAS V5.10.

Komponenti WINCC në kompjuterat workstation të operatorëve operon mbi sistemin operativ Microsoft Windows

Në rastin e upgradet të sistemit aktual kërkohet që softëaret e sistemeve SICAM PAS, WINCC dhe SICAM PAS CC të upgrade-ohen në versionin më të fundit të sistemit Kontroll-Monitorimit SCMS Sicam Pas dhe WinCC. **Por këto versione duhet të jenë të testuara më përpara në sistemin Operativ Ëindoës dhe nëse shoqërohen hotfixe të instalohen dhe këto të fundit.**

Versioni i SCMS Sicam Pas dhe WinCC apo i sistemit të ri , së bashku me broshurat e prodhuesit dhe specifikat përkatëse teknike të sistemit duhet të paraqiten për miratim paraprakisht pranë Autoritetit Kontraktor për aprovim të versionit të software -it që do të implementohet (OST-SMT). **Të gjitha instalimet dhe konfigurimet duhet të realizohen në prani të autoritetit kontraktor.**

Gjithashtu së bashku me upgrade-imin software nevojitet edhe upgrade-imi hardware i kompjuterit industrial te automatizimit dhe worksationave të operatorëve në versionet

hardware më të fundit sipas specifikimeve që më poshtë vijnë dhe kompatibël me versionet më të fundit të softuerëve që do instalohen në secilën makinë.

1.1.2 Kërkesat e përgjithshme për update-in e SCMS.

Sistemi i kontroll monitorimit i upgrade-uar në versionin më të fundit të Sicam PAS dhe WinCC ose sistemi i ri duhet të përmbajë të gjithë elementët në këtë nënstacion dhe të kryejë të gjitha funksionet bazike të kërkuara për operimin e sigurtë dhe korrekt të nënstacionit. Ky sistem duhet të realizojë me saktësi grumbullimin e të dhënave dhe procesimin e informacionit, monitorimin e plotë të nënstacionit, kontrollin e pajisjeve primare dhe sekondare, shfaqjen e të dhënave në kohë reale, raportimin nëpërmjet të gjithë eventeve dhe alarmeve të nevojshme për mbrojtjen, komandimin e trakteve dhe funksionet e komunikimit, arkivimin e të dhënave, komunikimin me të gjitha Qendrat e komandimit në distancë dhe gjenerimin e raporteve. Ai duhet të mundësojë kontrollin lokal të nënstacionit nëpërmjet workstations-ave të operatorëve, ndërmjet ndërfaqes njeri makine (HMI) dhe paketës software, e cila duhet të përmbajë një gamë të plotë dhe të kuptueshme të sistemeve të kontrollit si dhe të funksioneve të marrjes së të dhënave (SCADA). Gjithashtu duhet të përmbajë sinjalet për elementët e komunikimit si swichet dhe portat (gateway), station-bus, reletë (IED) për kontrollimin e trakteve dhe mbrojtjes së tyre.

Të gjitha materialet dhe pjesët të cilat nuk janë specifikisht të përmendura më poshtë të nevojshme për ngritjen, assemblimin dhe update-imin e sistemit ekzistues SCMS duhet të furnizohen dhe të konsiderohen për tu bërë pjesë e procedurës së update-imit të sistemit ekzistues të kontroll monitorimit.

Kërkesat minimale për sistemin e Upgrade-uar të kontroll-monitorimit të nënstacionit janë sic vijon:

- Operim korrekt dhe pa probleme i të gjithë nënstacionit nga secili workstation i operatorëve.
- Operim korrekt dhe pa probleme nga paneli i kontrollit të traktit ose reletë e kontrollit të traktit, me tregues pozicioni për të gjithë elementët si celsat, thikat e punës dhe të tokës e të tjera.
- Sistemi duhet të jetë kompatibël me të gjitha pajisjet për kontroll lokal, gjithashtu edhe me pajisjet dhe sistemet e ndërlidhura dhe ndëroperuara të Qendrës Kryesore Dispecer dhe Qendrës Emergjente të kontrollit.
- Operimi në mënyrë redundante në nivel funksional serveri dhe nivel ndërfaqe HMI.
- Përcaktimi dhe konfigurimi i saktë i “switching authority”. Për arsye sigurie në një moment të caktuar vetëm një operator (Control Station) ka të drejtë të kontrollojë elementët e nënstacionit nëpërmjet një sistemi kontrolli.
- Tregimi i të gjitha alarmeve dhe indikacioneve të cilat i bashkangjiten mbrojtjes rele dhe aktivizimit të trip-eve.
- Të gjithë treguesit për kontroll, monitorim, kontroll në distancë, qarqet mbrojtës dhe interlokues.

- Komunikimi me Qendrën Dispecer QDS, Qendrën e Emergjencës, në distancë nëpërmjet protokolleve standarte.
- Mbrojtje dhe menaxhim i kontrollit të Nënstacionit në distancë.
- Raportimi dhe regjistrimi i ngjarjeve(eventeve).
- Analizim i crregullimeve.
- Aplikimi i ngjyrosjes topologjike në skemat SLD(SLD-Single Line Diagram) të cilat do të operohen dhe monitorohen nga operatori. Elementët dinamik të skemës duhet të konfigurohen sipas ngjyrosjes topologjike sipas të ciles ngjyrat ndryshojnë në bazë të kualitetit të të dhënave dhe tensionit(në tension dhe të paenergjuara).

Në mënyre që të arrihen kërkesat e këtyre specifikimeve dhe detajet e projektit të sistemit të kontroll-monitorimit janë përgjegjesi e furnizuesit, por duhet të marrin paraprakisht aprovimin e Autoritetit Kontraktor.

Në mënyrë që të realizohet përshkrimi i aftësive teknike, furnizuesi duhet të paraqesë këto dokumenta sëbashku me ofertën e tij:

- Skemën bllok dhe funksionale të sistemit të propozuar për kontroll, mbrojtje dhe monitorim.
- Projekti i nderfaqes se kontrollit HMI (SCC) ku përfshihen te gjitha skemat operative qe shfaqen duhet te aprovohen nga autoriteti kontraktor. (Single Line Diagram)
- Specifikimet teknike dhe përshkrimin e detajuar të sistemit SCMS.
- Layout të sistemit të kontroll-monitorimit.
- Skemwn e topologjisw sw rrjetit tw brwndshwm tw sistemit lokal tw kontroll monitorimit
- Katalogun e sitemeve dhe paisjeve të cilat do të përdoren.
- Listen e elementëve dhe materialeve të perdorura për procedurën Upgrade.
- Broshurat dhe referencat e prodhuesit i cili furnizon me paisje dhe sistem monitorimi .
- Sigurimi i të gjitha licencave të reja për cdo komponent/protokoll komunikimi të instaluar në pajisjet server dhe Workstation
- Për të siguruar operimin korrekt të komponentit të sistemit të instaluar në pajisjet Workstation duhet të sigurohen të gjitha licencat e nevojshme në përputhje me versionin aktual të sistemit i cili do të instalohet dhe duke siguruar një numër të mjaftueshëm të Process Tag). Numri i tageve duhet të marri parasysh dhe shtimin e pajisjeve të reja(zgjerimin e nënstacionit) që mund të kontrollohen dhe monitorohen nga ky sistem kontrolli në të ardhmen. Duhet të sigurohet funksionimi i plotë i softuerit duke instaluar të gjitha licencat e nevojshme. Asnje modul i softit nuk duhet të funksionojë me licencë në demo mode.

4. Dizenjimi i sistemit

5. Principet e dizenjimit

Sistemi i kontroll monitorimit SCMS duhet të jetë një sistem dixhital për supervizimin dhe operimin e paisjeve primare (Switchgear) në këtë nënstacion. Ky sistem duhet të jetë i

kompletuar në të gjitha traktet ekzistuese përsa i përket elementëve të monitoruar dhe të kontrolluar.

Kontroll- monitorimi duhet të jetë i përshtatshëm për supervizim, operim dhe mirembajtjen e të gjithë nënstacionit duke përfshirë edhe zgjerimet në raste të mëvonshme (Data Points Spare).

Dizenjimi i hardware-it dhe i softwarit duhet të jetë i përshtatshëm për të gjitha nivelet e tensionit të përdorura nga Autoriteti Kontraktor në mënyrë të atillë që konceptimi teknik të standartizohet në rast se do të shtohen trakte të tjera.

Sistemi i Kontroll-Monitorimit duhet të dizajnohet në mënyrë të atillë që një personel pa njohuri kompjuterike të mund të operojë sistemin me lehtësi dhe kjo HMI të përmbajë karakteristika lehtësisht të kuptueshme të cilat nuk duhet të sjellin vonesa në operim.

Të gjithë elementët e nevojshëm për realizimin: e programimit, rregullimit, përcaktimit të parametrave, krijimin e data bazave dhe shërbimeve të tjera, edhe pse jo të specifikuar me detaje duhet të plotësohen nga Kontraktori.

Të gjitha paisjet përbërëse të sistemit SCMS duhet të instalohen në një panel te ri, i cili duhet të instalohet në godinën e nënstacionit në sallën ku ndodhen serverat ekzistues.

Komponentët e sistemit SCMS ekzistues si serverat, workstationat e të tjerë, duhet të çmontohen nga Kontraktori dhe duhet të mbahet një akt i përbashkët teknik në prani të Autoritetit Kontraktues për magazinimin e njësive të demontuara në Njësinë Operative përkatëse. Kontraktori duhet të njoftojë në formë zyrtare dy deri në tre javë përpara përpara se të fillojë punimet për çmontim të serverave dhe workstationave. Cdo proces pune që do të kryhet nga kontraktori duhet të jetë në supervizimin e specialistëve të mirëmbajtjes së këtyre sistemeve të kontroll- monitorimit.

Sistemi i Kontroll-Monitorimit duhet të dizajnohet për të qënë lehtësisht i modifikueshëm si nga ana fizike (hardware) gjithashtu dhe nga ana e software-it për të pasur mundësinë e modifikimit dhe shtimit të elementëve të rinj në nënstacion. Sisteme të monitorimit të gjëndjes së elementeve, moduleve dhe lidhjeve të komunikimit, duhet të jenë të përfshira në mënyrë të tillë që të rrisin sigurinë dhe të ulin kostot e mirëmbajtjes.

Dëmtimi i cili do prej paisjeve të sistemit ekzistues SCMS por edhe më tej, ose humbja e tyre është përgjegjësi e Kontraktorit dhe duhet dhënë zgjidhje prej tij. Ai duhet të propozojë zgjidhjen teknike dhe tja parashtrijë atë për aprovim Autoritetit Kontraktues në rast dëmtimi. Kontraktori duhet të ofrojë zgjidhje për të realizuar komunikimin e pajisjeve ekzistuese në nënstacion me serverat e rinjë duke ofruar driverat e duhur të komunikimit. Pra pajisjet e reja hardware duhet të përshtaten për të komunikuar me cdo pajisje ekzistuese në nënstacion. Për këtë qëllim sugjerohet një vizitë on site para së të fillojë implementimi i projektit, për të siguruar një pasqyrë të detajuar të gjëndjës aktual të sistemit dhe pajisjeve të ndërlidhura me këtë sistem.

Serverat e nënstacionit në arkitekturën e sistemit (SCMS) duhet të operojnë në formën Main dhe hot stand by mode. Në komponentin server nga ana funksionale i cili mbledh dhe organizon të dhënat e marra nga pajisjet rele apo cdo pajisje të lidhur me të (SICAM PAS

dhe Sicam PAS CC nw rastin e upgradet tw sistemit aktual) duhet të realizohet një “System Redundacy” pra duhet të kemi dy sisteme server (PAS/PQS) të konfiguruar tërësisht në mënyrë identike. Gjithashtu lidhjet e komunikimit midis qendrave të kontrollit remote dhe sistemit lokal (IED) duhet të jenë konform sigurisë n-1.

Kontraktori duhet të furnizojë një minimum prej 20% (rezerve) nga kapaciteti i nevojshëm për implementimin e suksesshëm të projektit të upgrade-imit, të lire hardware dhe software. Kjo duhet të reflektohet në një minimum prej 20% hardware të lirë për instalime te reja hardware dhe më shumë Data Points Software(Process Tags) në licencat e sistemit SCMS Sicam Pas e WinCC, për trakte të tjera në te ardhmen.

6. Siguria

Sistemi i Kontroll-Monitorimit duhet të dizajnohet për të përmbushur kërkesa shumë të larta për siguri dhe disponueshmëri lidhur me:

- Programimin e SCMS nga ana Software-ike
- Siguria kundrejt interferencave elektromagnetike (EMI)
- Kualitet të lartë të serverave dhe workstationave nga ana hardware-ike
- Switche me ndërtim modular dhe burim ushqimi redundant
- Software të testuara tërësisht dhe të ofruar si një zgjidhje e plotë e sistemit
- Programim lehtësisht i kuptueshëm dhe i zgjerueshëm
- Dokumentacion i detajuar grafik i të dhënave dhe trakteve
- Ndërtim i bazuar në vetë supervizim dhe funksione diagnostikues
- Asistencë, shërbim dhe pas shitjes

Siguria :

- Eksperiencë në kërkesat e sigurisë
- Process Now How
- Selektim i elementit përpara ekzekutimit gjatë operimit (Select before Operate)
- Paraqitja e gjëndjes së elementit të procesit nëpërmjet indikatorit të dyfishtë (double point)
- Indikator i gjëndjes së ndërmjetme të pozicionit
- Indikator dinamik në kohë reale të statusit të nënstacionit dhe elementëve të saj nëpërmjet aplikimit të ngjyrosjes topologjike

- Inicializimi automatik i sistemit në rastin e ristartimit të sistemit për shkak të ndërprerjes së tensionit të ushqimit. Të gjitha informacionet e nevojshme duhet të ruhen në memorie, në një rast të tillë.
- Informimi në kohë reale me anë të alarmeve për cdo event me prioritet në sistem
- Njësitë të pavarura të lidhura në linjën kryesore të komunikimit të nënstacionit
- Funksione back-up
- Realizimi i redundancës
- Sistemi SCMS duhet të operojë e izoluar nga infrastruktura të tjera të rrjetit (një rrjet i dedikuar) i cili duhet të përmbushë të gjitha standartet e sigurisë
- Në sistemin SCMS në pikat kritike brënda rrjetit të dedikuar të komunikimit duhet të ofrohen mbrojtje software/hardware dhe dedektive të sulmeve të rrjetit në formën e softwarëve antivirus, mbrojtje kundër aksesit të paautorizuar në burimet e sistemit, sistem firewall të cilat nuk duhet të rrezikojnë performancën e sistemit.
- Segmente të sistemit SCMS (workstation, serverat industrial, pajisjet switch, etj) duhet të kenë një regjistër të brëndshëm në të cilin ruhen të gjitha eventet dhe erroret që mund të ndodhin në secilën pajisje.
- Mbrojtja e cdo pajisjeje në raste mbitensioni, nëntensioni apo qark i shkurtër
- Instalimi i lincësave për cdo komponent softuerik
- Të jetë e mundur vazhdimi i kontrollit të pajisjeve edhe në raste dështimesh të ndryshme

Disponueshmëria duhet të arrijë të paktën vlerën e paraqitur në të dhënat teknike. Në mënyrë që të pasqyrohet kjo disponueshmëri e sistemit, pajisjet kryesore duhet të jenë të çiftuara në mënyrë redundante p.sh unazat e fibrave optike, linjat të tjera të komunikimit me relete. Ndërprerja e një lidhje komunikimi nga një pajisje me komponentët qendrorë nuk duhet të shkaktojë ndërprerjen e lidhjes midis këtyre të fundit ose pajisjeve të tjera.

Furnizuesi duhet të bëjë të qartë mënyrën se si arkitektura e ofruar arrin disponueshmërinë e kërkuar. Një bllok diagramë e sistemit si rrjedhje duhet të paraqitet së bashku me ofertën.

7. Aftësitë e sistemit

SCMS duhet të mundësojë operimin e plotë të të gjithë nënstacionit duke korresponduar me kërkesat e projektit. Siguria e përzgjedhjes së kontrollit ka një rëndësi të lartë dhe duhet të ndërmerren masa paraprake në software dhe hardware për të bërë të mundur që selektimi dhe ekzekutimi i një komande të gabuar të refuzohet. Ndërprerja e lidhjes së komunikimit, qoftë pjesore ose totale, e përkohshme ose permanente nuk duhet të shpjerë në veprim të kontrollit ose ekzekutimit. Zhurma, qoftë edhe të injektuara në sistemin e komunikimit nuk duhet të rezultojnë në një veprim të gabuar të kontrollit.

Softëare i përdorur për sistemin duhet të jetë i tipit standart me paketën server dhe klient të ndarë si në rastin e Sicam Pas dhe WinCC, SCC që mund ti ofrohet edhe klientëve të tjerë. Struktura e software-it duhet të jetë e dizenuar specifikisht për rëndësinë e kërkuar për pajisjet primare dhe operimin e nënstacionit 400/220/110Kv.

Sistemi duhet të startohet automatikisht pas ndërprerjes së tensionit të ushqimit, të gjitha informacionet e nevojshme duhet të ruhen në memorje, në nje rast të tillë.

Pas startimit automatik te sistemit në ekrane duhet të paraqiten të dhënat të cilat paraqiteshin më parë se sistemi të ndalej, workstationat e operatorëve (HMI) duhet të logohen në gjëndjen monitoruese (display only) pa të drejtë komandimi.

Duhet të jetë i mundur testimi i sistemit pa patur rreziqe të influencimit të nenstacionit. Pajisjet testuese duhet të përfshijnë funksionet dhe të dhënat.

8. Profili i komunikimit dhe gjendja aktuale e pajisjeve Rele.

Përkufizimi i profilit të komunikimit duhet të sigurojë që zgjidhja e ofruar të përputhet me minimumin e kërkesave të kërkuara në standartin IEC61850-3 dhe gjithashtu duhet të sigurojë që Arkitektura e ofruar e Sistemit SCMS mund të realizohet me produktet e ofruar dhe me implementimin e shërbimeve të derivuara prej saj IEC6249-3.

Sistemi i mbrojtjes rele dhe relete e komandimit të traktit (BCU) aktualisht komunikojnë me protkollin IEC60870-5-103. Më poshtë gjendet një tabelë e cila përmban listën e të gjitha pajisjeve BCU, modelin dhe versionet e firmware të tyre.

BAY	DEVICE	MLFB	FW
220kV OHL BAY (TEC-VLORE S/S)	6MD632 Bay Control Unit	6MD6321- 4EB220AA0---	V04.64.02
220KV OHL BAY (FIER S/S)	6MD632 Bay Control Unit	6MD6321- 4EB220AA0---	V04.62.03
220kV BUS COUPLER BAY	6MD632 Bay Control Unit	6MD6321- 4EB220AA0---	V04.62.03
220kV TR1 BAY	6MD632 Bay Control Unit	6MD6631-4EB22- 0FF0---	V04.63.01
220kV TR2 BAY	6MD632 Bay Control Unit	6MD6631-4EB22- 0FF0---	V04.63.01
110kV TR1 BAY	6MD632 Bay Control Unit	6MD6631-4EB22- 0FF0---	V04.63.01
110kV TR2 BAY	6MD632 Bay Control Unit	6MD6631-4EB22- 0FF0---	V04.63.01

110kV BUS COUPLER BAY	6MD632 Bay Control Unit	6MD6321- 4EB220AA0---	V04.62.03
110 kV OHL BAY (SELENICE S/S)	6MD632 Bay Control Unit	6MD6321- 4EB220AA0---	V04.62.03
110kV OHL BAY (VLORE 1 S/S)	6MD632 Bay Control Unit	6MD6321- 4EB220AA0---	V04.62.03
110kV OHL BAY (VLORE 2 S/S)	6MD632 Bay Control Unit	6MD6321- 4EB220AA0---	V04.62.03
110kV OHL Oriku S/S	6MD632 Bay Control Unit	6MD6321- 4EB220AA0---	V04.66.04
35 kV INCM TR1 BAY	7SJ642-1	7SJ6421- 4EB221FC0	V04.62.03
35 kV INCM TR2 BAY	7SJ642-1	7SJ6421- 4EB221FC0	V04.62.03

Në mënyrë që ky sistem të plotësojë standartet më të fundit të komunikimit duhet që të gjitha Rele e komandimit (BCU) të mund të komunikojnë me standartin e komunikimit IEC61850-3 në formë redundante me sistemin e kontrollit nepermjet rrjetit TCP/IP konform standartit IEC6249-3.

Të gjitha releve të komandimit të traktit (BCU) duhet tju intalohet moduli i komunikimit i cili e suporton protokollin IEC61850-3. Kontraktori duhet të bëjë të mundur upgrade të hardware dhe software të BCU-ve në mënyrë që keto të fundit të komunikojnë sipas standartit të më lartë përmendur.

Për shtimin e modulit të komunikimit EN100-O duhet të ndërmerren të gjitha hapat e nevojshme që relete përkatëse të ketë komunikim të plote me sistemin, gjë e cila duhet të realizohet nga kontraktori dhe të testohet nga autoriteti kontraktor. Gjithashtu duhet realizuar dhe parametrizimi i tyre, krijimi i të dhënave dhe konfigurimi i dataset për dërgimin e këtyre të fundit në protokollin IEC61850 në server.

Kërkohet që nga të gjitha pajisjet rele të sigurohet marrja e të dhënave gjithashtu dhe marrja e matjeve për cdo trakt nga reletë e mbrojtjes, të cilat aktualisht nuk ofrohen nga këto rele.

Pas instalimit të modulit përkatës (të tipit kartë EN100-O) duhet të realizohet ndërfaqesimi i komunikimit sipas standartit IEC61850-3 në DIGSI-4. Map-imi i të dhënave dhe krijimi i file .scd me të dhënat e dëshiruara. Përpara instalimit fizik të modulit në cdo pajisje Rele duhet të plotësohen disa kritere:

- Versioni i firmware-t të pajisjes rele duhet të jetë i pershtatshëm në manyre të atille që pajisjet SIPROTEC 4 në protokollin IEC61850 të mund të komunikojnë në rrjet.

-
- Instalim i firmware qe siguron kompatibilitetin ndërmjet pajisjes dhe modulit EN100-O+. Pajisjet me version me te ulet ne version firmware mund të përditësohen për të siguruar funksionalitetin e dëshiruar me modulën e larte përmendur.
 - Moduli i komunikimit ka firmware i cili gjithashtu është i përditësueshëm. Ky update-tohet duke përdorur ndërfaqen e ethernetit. Version 4.2 i Firmware te modulit e me lart kërkohet për funksionimin e rregullt të komunikimit.

Për ndërveprime të tjera të mëvonshme me të databazat, duhet që jo vetëm të dhënat të standartizohen por edhe mënyra e shërbimeve të aksesimit të tyre të jetë standarte nëpërmjet software-ve përkatës. Fushat përkatëse me interes të profilit janë:

- Shërbimet e komunikimit duhet të jenë: RSTP, HSR dhe PRP (IEC6249-3)
- Modelimi i të dhënave të databazave gjate konfigurimit duhet te realizohet me software plotësisht te ndarë për Operimin dhe Konfigurimin e serverave/gateway front-end.

Modelimi i të dhënave nuk është specifikisht i listuar por furnizuesi duhte të pajtohet plotësisht me nyjet llogjike të përshkruara në standartet IEC61850-3 Ed1 dhe Ed2 si dhe për pajisjet e paleve të treta të cilat mund të janë të nevojshme të integrohen në Sistemin SCMS.

Per Sistemin e Mbrojtjes Rele nevojitet qe te dhenat e derguara ne forme seriale RS-485 te mund te nderfaqesohen ne formen e komunikimit TCP/IP. Per te bere te mundur aksesimin e te dhena ne forme seriale nevojitet qe ne Serverat e Sistemit Scada te krijohen porta virtuale seriale per cdo unaze komunikimi. Per kete arsye kontraktori duhet te instaloje dhe konfiguroje nje Hub Serial RS485 ne TCP IP.

2.4.1- Marrja e matjeve nga relete e mbrojtjes


Si burim i dyte per marrjen e matjeve te trakteve te linjave dhe transformatoreve duhet te perdoren relete e mbrojtjes. Duhet te verifikohet mundesia e marrjes se matjeve nga keto paisje Rele mbrojtjeje me lidhjen ekzistuese IEC 103.

2.4.2 – Konvertimi i matjeve te matesave nga protokoll Profibus DP ne IEC61850.

Kontraktori ka per detyre te propozoje zgjidhjen e pershtatshme per konvertimin e matjeve qe aktualisht merren nga matesat me protokoll Profibus DP i cili duhet konvertuar ne protokoll standart IEC61850. Paisja Gateway e cila do propozohet duhet te permbushë kushtin e xjerrjes se 2 klienteve me protokoll IEC61850 te cilat duhet te shkojne tek te dy serverat e SCMS.

Skema e konvertimit te matjeve do te jete e tille:

Schematic configuration:



[sic_DPMID_Configuration_Basic_1, _-]

2.4.3 – HUB serial



Specifikimet hardware

Bus Interface Specification 10/100 BASE-T

Memory SDRAM 8 MB

Flash 4 MB

Enclosure Black Finished Steel

Installation Method Panel/Rack mountable

LED Indicators 100MB Ethernet, Collision, Ethernet Link/Activity, RX/TX per port, and Status

Dimensions 17.25" x 1.75" x 11"

Product Weight 105.9 oz

Electrical Specifications

Device

Current Consumption +120VAC 70 mA

Power Consumption (maximum) 8.4 W

Line Frequency 47-63 Hz

Line Voltage 90-264 VAC

ESD Surge Protection Provides minimum of 15KV for all serial lines. All Ethernet components are rated to 1.5KV magnetic surge protection.

Environmental Specifications

Air temperature

System On -37 to 74° C

System Off -40 to 85° C

Operating Humidity (non-condensing) 5% to 95%

Altitude 0 to 10000 Feet

Heat Output 28.6 BTU/Hr

MTBF (Mean Time Between Failures) 9.5 Years

Serial Communications

Connector Type DB9M

Number of Ports ≥ 8

9. Arkitektura e Sistemit

Për arsye sigurie dhe disponueshmërie sistemi lokal i kontroll monitorimit duhet të bazohet në një arkitekturë të shpërndarë dhe mbi konceptin e orientuar nga trakti (bay oriented) dhe inteligjencën të shpërndarë.

Funksionet duhet të jenë të shpërndara, të orientuara nga objekti dhe të lokalizuara sa më pranë procesit të jetë e mundur. Prosesi kryesorë duhet të ruhet në një databazë të shpërndarë.

Arkitektura e sistemit duhet të jetë e strukturuar në nivelet e mëposhtme:

- Nivel në distancë (Remote)
- Operimet e kontrollit të stacionit duhet të jenë të mundura nga qendrat e kontrollit në distancë
- Nivel stacioni (Lokal)
- Operimet e kontrollit të stacionit duhet të jenë të mundura nga kompjuterat workstation të operatorëve
- Nivel trakti
- Operimet e kontrollit të stacionit duhet të jenë të mundura nga pajisjet e kontrollit/ të mbrojtjes të traktit
- Nivel Aparati
- Operimet e kontrollit të stacionit duhet të jenë të mundura nga kontrolli lokal nga vetë pajisja fizike .

I gjithë nënstacioni duhet të kontrollohet dhe supervizohet nga dy qendra kontrolli në distancë dhe nga workstation i operatorit ndërkohë që traktet supervizohen dhe kontrollohen nga pajisjet në nivel trakti në kubikët e kontrollit.

Interlokimi ndërmjet niveleve të ndryshme duhet të jetë i mundur që të modifikohet. Sistemi lokal i kontroll monitorimit duhet të ndalojë rreptësisht kontrollin e stacionit në të njëjtën kohë nga nivele të ndryshme të kontrollit.

Sistemi duhet të mundësojë kontrollin dhe monitorimin e trakteve individuale nga niveli i traktit në rastin që linku i komunikimit dështon. Interlokimi i gjërë(i madh) i nënstacionit duhet të jetë i mundur edhe në rastin kur kompjuteri në nënstacion pëson një dështim ose mosfunksionim.

Në nivel stacioni, i gjithë nënstacioni duhet të kontrollohet dhe supervizohet nga kompjuterat workstation redundant (HMI).

Niveli i stacionit përmban funksione të orientuara nga stacioni, të cilat nuk mund të realizohen në nivel trakti, si për shembull : lista e alarmeve apo eventeve të cilat janë të lidhura me të gjithë nënstacionin. Komunikimi me qendrat e kontrollit në distancë nëpërmjet gateway duhet gjithashtu të jenë pjesë e nivelit të stacionit.

Për të ofruar besueshmërinë më të lartë serverat, kompjuterat e operatorëve dhe gateways duhet të punojnë plotësisht në mënyrë të pavarur, duke thirrur të dhënat direkt nga pajisjet në nivel trakti.

Sinkronizimi

Një orë master e dedikuar për sinkronizimin e të gjithë sistemit duhet të ofrohet për të gjithë stacionin. Pajisja e sinkronizimit duhet të jetë e pavarur nga serverat e sistemit dhe nga gateway, dhe gjithashtu duhet të sinkronizojë të gjitha pajisjet nëpërmjet bus-it të stacionit. Devijimet e orave të ndryshme të brëndshme nuk duhet të jenë më shumë se 1ms.

Ora master duhet të jetë e sinkronizuar nga një GPS.

Transmetimi i të dhënave ndërmjet pajisjeve në nivel stacioni dhe trakti duhet të realizohet ndërmjet busit të stacionit, i realizuar me fibra optikë, duke realizuar kështu një komunikim pa disturbanca.

Për të rritur performacën dhe disponueshmërinë, sistemi duhet të suportojë rrjete të ndryshme të ndara për busin e stacionit si për shembull: rrjete të ndara për nivele të ndryshme tensioni.

Në nivel trakti, pajisjet IED të kontrollit apo mbrojtjes duhet të ofrojnë të gjitha funksionet në nivel trakti në lidhje me kontrollin, monitorimin dhe mbrojtjen, inputet për indikacionet e statuseve dhe outputet për komandat. Pajisjet IED duhet të jenë direkt të lidhura tek elementët pa nevojën e ndonje transduceri (përcjellësi) shtesë.

Cdo sistem lokal i kontroll monitorimit duhet të përmbajë pjesët e mëposhtme kryesore funksionale:

- Kompjuterat industrial te automatizimit
- Kompjuterat workstation të HMI me databazën e të dhënave procesuese
- Ora Satelitore Master (marrës GPS)
- Procesimi i dështimeve të mbrojtjes
- Sistemi i shërbimit, analizës dhe inxhinierimit
- Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet komponentëve të ndryshëm të sistemit
- Mbledhja e të dhënave të nënstacionit dhe shpërndara e tyre ku është e nevojshme
- Pajisjet në nivel trakti dhe stacioni për kontroll, monitorim dhe mbrojtje
- Ndërfaqe procesimi paralele

10. Specifikimet Funktionale

Të gjitha funksionet e kontrollit dhe monitorimit duhet të ofrohen për të siguruar një operim të sigurtë dhe të besueshëm të të gjithë nënstacionit.

Më poshtë janë listuar funksionet minimale të nevojshme:

- Marrje e sinjaleve binare (treguesit njëfishe dhe dyfishë : sinjalet dhe komandat)
- Marrje e sinjaleve analoge (matjet e fuqise Aktive Reaktive, Rymave e tjerë)
- Monitorim i ekzekutimit të komandave
- Kontroll kronologjik automatik i procedurave standarte të kumutimit
- Interlokim stacioni dhe trakti
- Kontroll i Ancafkave të Transformatorit të Fuqisë së bashku me rregullatorin automatik të tensionit (AVR)
- Supervizim i gjithë nënstacionit
- Kontroll i të gjithë nënstacionit nëpërmjet workstation-ave të operatorëve
- Menaxhim alarmi
- Regjistrim ngjarjeje (evente + tripe)
- Tagimi
- Procesim i vlerave analoge
- Paraqitja e vlerave trend
- Vlerësimi dhe arkivimi i të dhënave historike
- Indikacion avarish
- Analizë disturbance
- Të gjitha pajisjet hardwerike ,softuerike dhe të telekomunikacionit për kontroll remote
- Kontroll emergjence për cdo trakt nga unit bay përkatës dhe paneli i kontrollit lokal
- Menaxhim userash dhe përcaktimi i roleve për cdo user
- Sistem i sinkronizuar me të gjitha pajisjet dhe sistemet e lidhura në të
- Aplikim i konceptit të redundancës ne servera(hot-stand by)
- Aplikim i konceptit të redundancës në nivel workstationit në mënyrë të tillë që të dy workstation-at e operatorëve të jenë tërësisht të njëjtë dhe nga ana funksionale dhe ajo hierarkike

Aparatet e ndryshme me tension të lartë dhe tension të mesëm brenda nënstacionit duhet të operohen nga vënde të ndryshme:

- nga qendrat kontrollit remote (më shumë se tre qendra kontrolli)
- nga kompjuterat e operatorëve
- nga Reletë e Kontrollit dhe të Mbrojtjes (IEDs- Intelligent Electronic Devices)
- nga pajisje individuale

Duhet të sigurohet ne porgramimin e softwarit të SCMS, që operimi është i mundur vetëm nga një operator në një cast të caktuar kohe. Prioritetet e qarta të kontrollit duhet të shmangin rastin ku operimi i një celësi të vetëm të iniciohet në të njëjtën kohë nga më shumë se një nivel kontrolli, si për shembull : të kontrollohet ne nivel

remote, nivel stacioni, nivel trakti ose nivel aparati. Prioriteti duhet te jete gjithmone ne nivelin me te vogel te lejuar te kontrollit.

11. Funkcionet në nivel Stacioni

Për supervizimin e gjithë nënstacionit në nivel stacioni minimalisht duhet të instalohen dy pajisje server redundant dhe dy workstation operatori (HMI), me mundësi e zgjerimit në shumë kompjutera workstation për operatorët.

Pozicioni i pajisjeve të kumutimit (si për shembull: celsi, thika, thika tokës, ancafkat e transformatorit etj) duhet të mbikqyren në mënyrë të përhershme. Një alarm duhet të iniciohet nëse këto treguesit e pozicioneve janë inkosistente ose nëse koha që kërkon mekanizmi i operimit për të ndryshuar pozicionin e tejkalon një limit të paracaktuar.

Cdo ndryshim i dedektuar i pozicionit duhet të jetë menjëherë i dukshëm në Diagramën Njëpolare në ekranin e kompjuterit workstation të operatorit (HMI), e regjistruar në listën e eventeve dhe gjithashtu një kopje fizike e printuar. Alarmet duhet të gjenerohen/iniciohen në rastin e ndryshimeve spontane të pozicionit.

Oferta duhet të përfshijë operimin e gjithë vëndit të punës (duke përfshirë tavolina, karrike etj) për cdo operator dhe workstation në lidhje me sistemin SCADA..

12. Kompjuteri Industrial i Automatizimit të Stacionit

Në niveli stacioni sistemi SCMS duhet të përfshijë dy (Automation) PC Industrial për funksione supervizimi monitorimi dhe kontrolli, i pajisur me mikroprocesorë me performancë të lartë Intel Xeon ose ekuivalent dhe sistem operimi SCADA në kohë reale.

Për të fituar aftësi të avancuara, keto njesi duhet të jetë te konfiguruar në sistem redundant.

Kompjuteri Industrial duhet të ketë akses tek të gjitha nënstistemet në nivel trakti BCU, rele mbrojtje, workstation operatori e tjere. Të mbledhi sinjale dhe informacion, të lëshojë komanda dhe të performojë procesimin e kërkuar të sinjalit për nënstacionin përkatës dhe te trakteve respektiv.

Kjo njesi duhet të vendoset bashkë më të gjitha pajisjet input/output të nevojshme në panelin e ri brënda dhomës së kontrollit. Kompjuteri i nënstacionit duhet të ushqehet nga energjia elektrike e baterisë së nënstacionit ne menyre direkte dhe duhet te disponoje dy grupe te vecante ushqimi.

PC i Automatizimit duhet të kenë një komunikim të dyfishtë me reletë e mbrojtjes dhe pajisjet e kontrollit në nivel trakti dhe me pajisjet e sistemeve sekondare në nënstacion. Komunikimi me reletë e mbrojtjes dhe pajisjet e kontrollit në nivel trakti dhe sistemet sekondare në nënstacion duhet të jenë në përputhje me standartin IEC 61850-3 dhe me redundancen ne IEC 62439-3.

Serverat duhet të kenë komunikim të dyfishtë me kompjuterat workstation të operatorëve.

Gjithashtu duhet të ofrojnë komunikim të dyfishtë me të gjitha qendrat e kontrollit. Komunikimi me qendrat e kontrollit duhet të jetë në përputhje me standartin IEC 60870-5-104.

Versioni më i fundit i komponentit të sistemit SCADA SICAM PAS i cili do instalohet në serverat e rinj të sistemit duhet të suportojë komunikimin me të gjitha pajisjet ekzistuese në sistem duke përfshirë dhe upgradet e protokolleve përkatëse bashkë me licencat e nevojshme.

13. Workstationi i Operatorit (HMI)

Workstationi i operatorit (HMI) duhet të ofrojë supervizim të nënstacionit:

- Shfaqje të ekraneve të përcaktuara për përdoruesin (statusi i celesit dhe vlerat analoge), ekranet standarte, ekranet e grafikut të trendeve dhe raportet.
- Dialogje efektive dhe të sigurta për kontrollin manual të nënstacionit dhe për lëshimin e sekuencave të kontrollit, procedurat “selektto përpara ekzekutimit”(Select before operate) janë të nevojshme.
- Tagimi (emërtimi dhe vendosja e shënimeve)
- Shfaqja e alarmeve dhe ngjarjeve në ekrane të operatorëve dhe në fletë të printuara nwqoftw se do të nevojitet.

HMI duhet të jetë një workstation, i bazuar në sisteme kompjuterike me performance të larta dhe pa nevojë mirëmbajtjeje, të pajisura me dy monitore me ekranë të sheshtë LED. Monitorët me ekran të sheshtë LED duhet të kenë një madhësi minimale prej 27 inc diagonalja. Grafika e ngjyrave kërkohet me rezolucion të lartë (full HD 1920 x 1080 px).

Për më tepër, duhet të sigurohet një printer me ngjyra me shpejtësi të lartë për kopjet grafike fizike të shfaqjeve dhe për raportet.

Tensioni alternativ për severat, workstationat e operatorëve(HMI), monitorët dhe printer duhet të ofrohet nga furnizimi me energji i dy inverterave (110Vdc to 230Vac) ose modul vetjak DC.

Operatori duhet të ketë akses nëpërmjet workstationit të operatorit (HMI) tek të gjitha pajisjet e shpërndara inteligjente IED.

Procedura e operimit duhet të përdoret dhe kuptohet lehtësisht. Ndërrimi i statusit të nënstacionit në termat e vlerave aktuale të matjeve (Rrymat, Tensionet, Fuqia aktive dhe ajo reaktive) dhe gjithashtu të pozicioneve të ancafakave të transformatorit duhet të prezantohen në ekran.

Workstationi i operatorit (HMI) duhet ti japi aksese operatorit tek pajisjet me nivele tensioni të larta dhe të ulëta.

Selektimi i ndërfaqeve, vendosja e parametrave, konfirmimi i alarmeve, printime të selektuara të raporteve dhe outputeve të komandave duhet të realizohen nga tastieria e operatorit.

Sistemi duhet të ofrojë dy lista të ndryshme përkatësisht për alarmat dhe ngjarjet, të cilat duhet të jenë të selektueshme në monitor nga operatori. Përveç këtyre listave, në ekran duhet të realizohet një afishim kronologjik i një alarmi ose ngjarjeje në një log ngjarjeje.

Një alarm akustik duhet të tregojë një anomali dhe të gjitha alarmet e konfirmuara duhet të shfaqen në cdo ekran të zgjedhur nga operatori.

Më poshtë listohen elementet që duhet të shfaqen minimalisht në workstationin e operatorit(HMI):

- Diagramat e gjëndjeve të cilat tregojnë statusin e kumutimit dhe vlerat e matura të :
 - Te gjithë nenstacionit
 - Cdo niveli tensioni të nënstacionit
 - Cdo seksioni të zbarës të nënstacionit
- Nivelet e autoritetit të userave
- Procedurat e komandimit
- Dialogjet e kontrollit
- Tagimi
 - Pengim/moslejim kontrolli
 - E lejuar per tu punuar
 - E tokëzuar
- Lista e ngjarjeve
 - Të orientuara nga nënstacioni
 - Të orientura nga trakti
 - Të brëndshme të sisetmit të kontrollit dhe monitorimit të nënstacionit
- Lista e alarmeve
 - Të orientura nga nënstacioni
 - Të orientura nga trakti
 - Të brëndshme të sistemit të kontrollit dhe monitorimit të nënstacionit
- Loget e ngjarjeve dhe alarmeve
- Diagrama e statusit të sistemit
- Raportet
- Vlerat trend.

14. Diagrama e gjendjes

Diagramat e gjendjes të shfaqura në workstationin e operatorit (HMI) duhet të përfshijnë minimalisht një diagram të gjithë nënstacionit, një diagramë individuale për cdo nivel tensioni të nënstacionit dhe diagramat individuale për seksion të zbarave të nënstacionit.

Një diagram duhet të jetë e aftë të tregojë skemën një polare me të gjitha të dhënat perkatëse.

Në të gjitha diagramat duhet të konfigurohet ngjyrosja topologjike sipas të cilës cdo element apo pjesë e skemës ndryshon ngjyrosjen e saj në bazë të nivelit të tensionit (gjendjes të energjizuar apo të tokëzuar) dhe kualitetit të të dhënave.

Ndërfaqet e reja duhet të dizajnohen në një dialog interaktiv pa cuar gjithë sistemin e kontrollit të nënstacionit off-line. Layoutet e ndërfaqeve janë subjekt miratimi nga Autoriteti Kontraktues dhe duhet të propozohet paraprakisht zgjidhja softwerike .

15. Nivlet e autoritetit të përdoruesit

Duhet të jetë e mundur të kufizohet aktivizimi i diagramës së stacionit brenda një grupi të autorizuar përdoruesish. Atëherë cdo përdoruesi duhet të jepen keto lloje të drejtash të aksesit për cdo grup objektësh :

- Paraqitja e statusit (lexim)
- Operim normal (per shembull: kycje/ckycje e apartatit)
- Operim i kufizuar (per shembull: bypasim i interlokimeve)
- Administrator sistemi.

Për qëllime mirëmbajtjeje dhe inxhinierike të nënstacionit, duhet të jenë në dispozicion këto nivele autorizimi:

- Moslejimi i punës inxhinierike
- Lejimi i konfigurimeve dhe punëve inxhinierike
- Lejimi i menaxhimit të gjithë sistemit

Të drejtat e aksesit duhet të përcaktohen nga fjalëkalime hierarkike të përcaktuara gjatë procedurës së logimit. Vetëm administratori i sistemit duhet të ketë të drejtë të shtojë/heqi përdorues dhe të ndryshojë të drejtat e aksesit.

16. Procedurat e komandimit

Për të siguruar një shkallë të lartë të sigurisë kundra veprimeve të padëshiruara duhet ofruar një procedurë speciale të operimit e tipit “selektim përpara ekzekutimit”. Pas selektimit operatori duhet të jetë në gjendje të njohi pajisjen e selektuar në ekran dhe të gjitha pajisjet e tjera të kumutimit duhet të jenë të bllokuara.

Operatori duhet të jetë në pozicionin e ekzekutimit të një komande nëse celësi nuk është i bllokuar dhe nuk thyhet/preket asnjë kusht interlokimi. Kushtet e interlokimit duhet të kontrollohen nga skema interlokuese e implementuar në nivel trakti.

Pas ekzekutimit të komandës, operatorit duhet të marri një informacion që pozicioni i ri i kumutimit është arritur ose një tregues i cili tregon që procedura e kumutimit ishte e pasuksesshme bashkë me treguesin e arsyes së këtij mosfunksionimi.

17. Dialoget e kontrollit

Operatori duhet ti japi komanda pajisjes së tensionit të lartë dhe të tensionit të mesëm nëpërmjet klikimeve të mousit mbi celsat e lokalizuar në diagramë. Futja e të dhënave duhet të realizohet nëpërmjet tastierës ose mous-it. Duhet të jenë në dispozicion dialogjet e dedikura të kontrollit të cilat kontrollojnë të paktën pajisjet e shënuara më poshtë:

- Celësat dhe thikat
- Ancafkat e Transformatorit
- Pajisjet e sekuencave të kontrollit
- Pajisjet e heqjes së ngarkesës (nese ka).

Lista e ngjarjeve të nënstacionit duhet të përmbajë ngjarje të cilat janë të rëndësishme për kontrollin dhe monitorimin e nënstacionit, një shembull ngjarjeje: “ Celësi i kycyr”. Koha duhet të shfaqet duke i koresponduar ngjarjes në kohë realë me një rezolucion minimalisht 10ms.

Operatori duhet të jetë i aftë të thërrasi në ekran dhe në cdo cast të kohës , listën e ngjarjeve të renditura në mënyrë kronologjike për të gjithë nënstacionit ose pjesë të tij.

Një kopje fizike e cdo liste ngjarjesh të shfaqura duhet të jetë e mundur të printohet. Ngjarjet duhet të regjistrohen në një listë kronologjike ngjarjesh në të cilën tipi i ngjarjes dhe koha e tij e ndodhjes duhet të specifikohen. Duhet të jetë e mundur që të gjitha ngjarjet të ruhen. Informacioni duhet të jetë i aksesueshem gjithashtu edhe nga loget e ngjarjeve.

Lista kronologjike e ngjarjeve duhet të përmbajë:

- Ndryshimet e pozicioneve të celësave, thikave, pajisjeve tokëzuese dhe veprimet ancafkave
- Treguesit e vemprimeve të releve të mbrojtjes
- Sinjal avarie nga panelet e komandimit te aparateve primare (sëitchgear)
- Tregues në rastion kur vlerat e matura analoge i kalojnë limitet e sipërme dhe të poshtme
- Humbje e komunikimit
- Komandimet e operatorit dhe tagimet.

Filtrat për selektimin e një tipi ose grupi të caktuar të ngjarjeve duhet të jenë në dispozicion. Filtrat duhet të jenë të ndërtuar që të mundësojnë shikimin e ngjarjeve të grupuara për:

-
- Date dhe kohë
 - Trakt
 - Pajisje
 - Funksion
 - Klase alarmi

18. Lista e alarmeve

Avaritë dhe defektet që mund të ndodhin në nënstacion duhet të tabelohen në listën e alarmeve të nënstacionit dhe duhet të jenë në dispozicion që njëkohësisht të transmetohen në qendrat kontrollit në distancë. Ajo duhet të përmbajë alarmet e pakonfirmuara dhe avaritë e pazgjidhura.

Gjithashtu duhet të shfaqet data dhe ora e gjenerimit në kohë reale. Koha duhet të shfaqet duke i koresponduar alarmit në kohë reale me një rezolucion minimalisht 1ms. Sekuenca e treguesit të alarmit në listën e alarmeve duhet të koincidojë më ndodhjen e alarmit.

Lista e alarmeve duhet të konsistojë në shfaqjen/afishimin e përmbledhjës së situatës së alarmeve prezente. Cdo alarm duhet të raportohet në një rresht që përmban:

- Datën dhe kohën e alarmit
- Emrin e objektit alarmues
- Një tekst përshkrues
- Gjëndja e konfirmimit

Operatori duhet të jetë në gjëndje të selektojë një ndërfaqje e cila përmban vetëm një pjesë ose nënseksion të listës së përgjithshme të gjithë alarmeve.

Operatori duhet të jetë në gjëndje të konfirmojë alarmet nëpërmjet tastierës dhe alarmet e pakonfirmuara të markohen/shënohen në listen e alarmeve. Avaritë të cilat shfaqen dhe zhduken nga lista e alarmeve pa u konfirmuar duhet të markohen në mënyre të vecantë në këtë listë. Duhet të jenë në dispozicion filtrat për selektimin e një tipi ose grupi të caktuar alarmesh.

Lista e alarmeve duhet të shfaqet në ekran. Duhet të jetë e mundur të merren kopje fizike të listave të alarmeve nëpërmjet printerit. Karakteristikat për printime sensitive duhet të ofrohen.

Lista e alarmeve të brëndshme të Sistem Kontroll Monitorimit të nënstacionit

Sistemi i kontrollit dhe monitorimit të nënstacionit duhet të realizojë një vlerësim aktual të alarmeve të brëndshme të këtij sistemi, si për shembull : defekt në switch të këtij sistemi ose defekt në nyjet e komunikimit të këtij sistemi, reduancën e sistemit. Ai duhet të përmbajë alarmet e pakonfirmuara dhe avaritë e vazhdueshme sic u përmendën dhe më parë.

Loget e alarmeve dhe ngjarjeve

Loget e alarmeve dhe ngjarjeve duhet të jenë listime spontane të ngjarjeve dhe alarmeve të shfaqura në monitor. Këto loge duhet të përmbajnë të njëjtat alarme dhe ngjarje që u përmendëm më parë, por të listuara kronologjikisht sapo ato gjenerohen në kohë reale.

